



REPUBLICA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Nr i faq Broj stranica Nr. pages	03-03/DPK 02
Nr Prot Bi Prot Prot No Data Datum Date	01-2075/16 17-06-2016
KOSHTINE	



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE  
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	17/06/2016
REFERENC-Ë:	AKK- DPK- DPKPP-03-03/1958/16
PËR/ZA/TO:	z. Isak KEROLLI Drejtor i Zyrës Ekzekutive të Prokurimit - KEK
CC:	z. Arben GJUKAJ Drejtor Menaxhues - KEK
NGA/OD/FROM:	Hasan PRETENI, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me tenderin: Shërbimet e telefonisë mobile

I nderuar z. KEROLLI,

Në mbështetje të nenit 142 (par. 3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 (par. 1, nën par. 1.1.) dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 8 (par. 4), 9 (par. 1, nën par. 1.6), 12 (par. 2) dhe 19 (par. 1, nën par. 1.6) të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014 së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me Tenderin: “Shërbimet e telefonisë mobile” me numër prokurimi KEKO/16/140/221, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

### OPINION

Në lidhje me Tenderin “Shërbimet e telefonisë mobile” me numër prokurimi KEKO/16/140/221, në mënyrë që të procedohet në pajtim me dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 04-L/042 për Prokurimin Publik, i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin Nr. 04/L -237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

## A r s y e t i m

Ju si zyre e prokurimit pranë autoriteti kontraktues Korporata Energjetike e Kosovës keni iniciuar Procedurën e Prokurimit me titull: ‘Shërbimet e telefonisë mobile’ me numër prokurimi KEKO/16/140/22, e cila është publikuar në faqen elektronike të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik më datë 31/05/2016. Për këtë aktivitet të prokurimit keni paraparë procedurë të hapur për punë, me kriter “Çmimi ekonomikisht më i favorshëm”

Agjencia Kundër Korrupsion ka identifikuar këtë aktivitet të prokurimit si lëndë për trajtim dhe më datë 06/06/2016 përmes “Kërkesë për Dokumentacion” ju ka kërkuar dokumentacionin e caktuar. Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në dispozicion për këtë procedurë të prokurimit Agjencia kundër Korrupsion nuk ka hasur në elemente të kundërligjshme, megjithatë, në përputhje me mandatin që ka, Agjencia ka vlerësuar se duhet të jetë prezentë në vlerësimin e ofertave. Në sajë të këtij veprimi, Agjencia më datë 13/06/2016 ju ka njoftuar përmes “Njoftim për pjesëmarrje në vëzhgim” që do të vëzhgojmë aktivitetin e vlerësimit për këtë tender. Pas kësaj kemi pranuar njoftimin se më datë 15/06/2016 do të filloj vlerësimi, ku edhe kemi qenë prezent.

Gjatë procesit të vlerësimit është konstatuar se kanë aplikuar dy operator ekonomik “Telekomi i Kosovës” dhe “IPKO”. Që të dy operatorët ekonomik ishin të përgjegjshëm administrativisht, ndërsa në tërësi doli të jetë i përgjegjshëm vetëm operatori ekonomik “Telekomi i Kosovës” i cili edhe u rekomandua nga komisioni si i përgjegjshëm.

Operatori tjetër ekonomik “IPKO” krahas pjesës administrative që i kishte plotësuar si duhet, nuk ka dorëzuar tender të përgjegjshëm, ngase në disa pozicioni ka paraqitur çmimin “0.00”, gjë që një veprim i tillë sipas ligjit e nxjerr si të pa përgjegjshëm automatikisht, aq më tepër kur edhe autoriteti kontraktues në dosjen e tenderit kishte paraqitur, Vërejtje: *Operatorët Ekonomik janë të obliguar që të japin çmim për secilin pozicion të dhënë më lartë. Ofertimi me vlerë “0.00” ose falas do ta eliminoj ofertën tuaj nga konkurrenca*”

Agjencia kundër Korrupsionit ju rekomandon të vazhdoni tutje me aktivitetin e prokurimit konform ligjeve në fuqi.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !